



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO	
AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT AGENCIJA PROTIV KORRUPCIJE ANTI-CORRUPTION AGENCY	
Dep. Dep. Dep.	2-D/DPK
Nr. ifaq Broj stranica Nr. pages	62
Nr. Prot B-Prot Prot No	01-4056/15
Data Datum Date	11.11.2015
PRISHTINE	



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosova

**AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
AGENCIJA PROTIV KORRUPCIJE
ANTI – CORRUPTION AGENCY**

Duke u bazuar në nenin 11 paragrafi 1.1, nenin 5 paragrafi 1.5 dhe nenin 18 paragrafi 10 dhe 11 të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupcionit si dhe nenin 24 paragrafi 11 dhe 12 të Rregullorës së Punës të Agjencisë kundër Korrupcionit, Drejtori i Agjencisë kundër Korrupcionit me datë 10.11.2015, nxjerr këtë:

V E N D I M

I. Mylllet rasti me Nr. AKK-03-02-3025-15 për z.Rafet Rama – Deputet në Kuvendin e Kosovës, për shkak se nuk ka prova të mjaftueshme që dëshmojnë situatën me konflikt interesit në ushtrimin e funksionit të tij publik .

II. Rasti mund të rihapet në çdo kohë kur mund të paraqiten rrethana të reja.

A r s y e t i m

I. Rasti i hapur nën dyshimin e bazuar për Konflikt interesit në ushtrimin e funksionit publik, me nr. AKK-03-02-3025-15, për Zyrtarin e lartë, z. Rafet Rama – Deputet në Kuvendin e Kosovës dhe njëkohësisht i punësuar në Ndërrmarrjen private IFJB “Capital” sh.p.k., është trajtuar sipas procedurës së paraparë ligjore, për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik (Ligji Nr. 04/L-051).

Zyrtari i lartë, z.Rama fillimisht është njoftuar me një shkresë zyrtare nga Agjencia kundër Korrupcionit, pas të cilës ai është paraqitur ne takim me zyrtarët e Agjencisë kundër Korrupcionit, me ç'rast, janë ballafaquar faktet në lidhje me dyshimet e hedhura për konflikt interesit në ushtrimin e funksionit publik.

Në këtë takim nga z.Rama është kërkuar që ai të na dëshmoj me Kontratë cila është pozita e tij dhe cilat janë detyrat dhe obligimet e tij në institucionin financier “Capital” Sh.p.k.

Z.Rama në Agjencinë kundër Korrupcionit ka sjellë Kontratat e kaluara dhe ate valide me IFJB “Capital” sh.p.k. (DPK/DPKI-03-02-3655/15) në të cilat shihet se ai ka pasur një Kontratë në periudhën prej 01.03.2013 deri 01.03.2015, në pozitën “Koordinator për pune në IFJB “Capital”.

Kjo kontratë, me po këto detyra dhe përgjegjësi, z.Rama i është vazhduar përsëri me datë 01.03.2015 deri në periudhën 31.12.2015.

Ligji për Parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik, nuk ka paraparë brenda këtyre konditave, ndalesë ose kufizim në ushtrimin e funksionit publik.

Ndërsa Ligji për të Drejtat dhe Përgjegjësitë e Deputetit (Nr.03/L-111), në kuadër të Mospërputhshmërisë me aktivitetet ekonomike, për Deputet ka paraparë ndalesa që ata të mos kenë të drejtën të jenë Anëtar të Bordit në ndonjë kompani private ose publike (Neni 7, paragrafi 1). Pastaj, po ashtu me ketë ligj ndalohet që Deputeti gjatë mandatit të tij të veproj në cilësinë e këshilltarit apo përfaqësuesit ligor i kompanive private ose bizneseve (Neni 7, paragrafi 2), si dhe disa ndalesa tjera, por që nuk lidhen me rastin konkret dhe me pozitën konkrete të Deputetit Rama, të prezantuar sipas kontratës.

Megjithatë zyrtari i lartë publik z.Rafet Rama duhet që gjithmonë gjatë ushtrimit të funksionit publik të ketë parasysh situatën e konfliktit “rast për rast” të interesit. Ne raste të tilla ai, si dhe çdo zyrtar i lartë publik duhet të respektojnë dhe të veprojnë në pajtim me nenin 13, paragrafi 1, 2, 3, të Ligjin për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik, i cili shprehimisht thotë:

1. Çdo zyrtar i lartë gjatë ushtrimit të funksionit të tij publike, në bazë të njohurive të tij dhe në mirëbesim, detyrohet që të bëjë vet deklarimin paraprak, rast për rast, të ekzistencës së interesit të tij private lidhur me vendimmarrjen në një çështje të caktuar, që mund të bëhen shkak për lindjen e një konflikti të interesit.
2. Deklarimi rast për rast i interesave private bëhet çdo herë nga zyrtari i lartë, kur kjo kërkohet nga eprori ose nga institucioni mbikëqyrës. Deklarimi si rregull duhet kërkuar dhe bërë paraprakisht. Kur kjo nuk është e mundur ose kur nuk ka ndodhur, deklarimi duhet të kërkohet të bëhet sa me shpejt që të jetë e mundur.
3. Vetë deklarimi si rregull bëhet me shkrim, kur zyrtari i lartë përfshihet në një vendimmarrje për ndonjë çështje të caktuar.

II. Në pajtim me nenin 18 paragrafi 11 të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korruptionit. Agjencia mund të rihap rastin në çdo kohë nëse paraqiten rrethana të reja.

Andaj u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi iu dërgohet:

- Zyrtari i lartë publik
- Drejtorit të DPK-së
- Z./zpj. (zyrtari përgjegjës)
- Z./zpj. (zyrtari ndihmës)

